

KONTRATË
TRANSFERIM KUOTASH
(DHURIM)

Sot më datë 06.10.2021, bazuar në Nenet 73, 74, 75 të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, Nenin 7 të Statutit të Shoqërisë me Përgjegjesi të Kufizuar “Farmaci Genesis 2” sh.p.k. nënshkruhet kjo Kontratë transferimi për dhurim kuotash:

Pala DHURUESE

Z. Ergys Aliko, lindur në Tiranë, më 1.07.1984, identifikuar me ID CA44413BX, banues në Itali, me përafqësues Z. Erion Aliko, sipas prokurës date 22.09.2021, nr 5408, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, më poshtë kesaj kontrate do të referohet si palë dhuruese.

Pala PRANUESE

Znj. Ines Abdyli, lindur në Lezhë, më 25.09.1988, identifikuar me ID I85925073V, banuese në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, më poshtë kesaj kontrate do të referohet si pale përfituese,

të cilët shprehën vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë për të përpiluar dhe nënshkruar këtë kontratë transferimi të kuaotave të kapitalit, si më poshtë vijon:

Dispozita të përgjithshme:

1. Pala DHURUESE, zotëron 1 kuotë në vlerën 9000 lekë që përbën 90% të kapitalit të shoqërisë “Farmaci Genesis 2” sh.p.k, e regjistruar ne QKB dhe organet e tjera tatimore me NIPT M18321301I, me ortak si më poshtë:

- **Z. Ergys Aliko** zotërues i 1 kuotë në vlerën 9000 lekë që përbën 90% të kapitalit të shoqërisë “Farmaci Genesis 2” sh.p.k.

- **Znj. Ines Abdyli**, zotëruese e 1 kuote në vlerën 1000 lekë që përbën 10% të kapitalit të shoqërisë

2. Pala Dhuruese me vullnet të lirë, bazuar në nenin 75 të Ligj Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, pjeston kuotën e tij në vlerën 9000 lekë që përbën 90% të kapitalit të shoqërisë “Farmaci Genesis 2” sh.p.k në dy kuota, 1 kuotë në vlerën prej 5000 lekë e cila përfaqëson 50 % të kapitalit të shoqërisë dhe një kuotë në vlerën prej 4000 lekë e cila përfaqëson 40 % të kapitalit të shoqërisë.



Objekti i Kontratës:

Pala dhuruese, **Z. Ergys Aliko**, i dhuron me vullnet të lirë palës pranuese një pjesë të kapitalit që ai zotëron në kompani, konkretisht ai dhuron një kuotë në vlerën 4000 lekë që përbën 40% të kuotave të kapitalit në shoqërinë “Farmaci Genesis 2” sh.p.k.

Pala pranuese, **Znj. Ines Abdyli**, me vullnet të lire dhe të plotë i pranon palës dhuruese **Z. Ergys Aliko** kuotën në vlerën 4000 lekë që përbën 40% të kuotave të kapitalit në shoqërinë “Farmaci Genesis 2” sh.p.k.

Transferimi i Pronësisë:

Me nënshkrimin e kësaj kontrate transferimi (dhurimi), të kuotës të cituara më lart, pala dhuruese zhvishet nga 40% të kapitalit të barabartë me një vlerë prej 4000 lekë që gëzon në kompani, dhe pala pranuese bëhet zotëruese e pjesës së dhuruar 40% +10% të kuotave të zotëruara, pra 50% të kapitalit me një vlerë prej 5000 lekë.

Pas nënshkimit të kësaj kontrate të shoqërisë “Farmaci Genesis 2” sh.p.k, janë:

- 1). **Ergys Aliko**-zotëruesi 50 % të kapitalit të kompanisë, ose 1 kuote me një vlerë prej 5000 lekë;
- 2). **Ines Abdyli**- zotëruese e 50% të kapitalit të shoqërisë, ose 2 kuotave me një vlerë totale prej 5000 lekë.

Vlera nominale e kapitalit të shoqërisë pas këtij veprimi mbetet e pandryshuar, 10000 lekë.

Pala pranuese merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë sipas përqindjes së kuotave e kapitalit që gëzon në shoqërinë në momentin e nënshkimit të kontratës së dhurimit e në vijim. Pala pranuese nuk ka asnjë përgjegjësi për detyrimet që pala dhuruese mund të ketë jashtë shoqërisë.

Dispozita përfundimtare:

Kontrata u përpilua në katër kopje me fuqi të barabartë, njëra prej të cilave depozitohet në rregjistrin tregtar duke u bërë shënimet për ndryshimet përkatëse.


PALËT KONTRAKTUESE

PALA DHURUESE

ERGYS ALIKO

Përfaqësuar nga

ERION ALIKO



PALA PRANUESE

INES ABDYLI

Ines Abdyli

